



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 1452/14 Prot.

Laç, më 28.03.2023

VENDIM

Nr. 24, Datë 24.03.2023

“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE SHUARJEN E ZJARREVE NË FONDIN PYJOR/KULLOSOR NË BASHKINË KURBIN PËR VITIN 2023”

Mbështetur në nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja "k" të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar ;neni 30 pika 4, gërma 'b/ 'c' të Ligjit nr.57/2020 "Për pyjet"; Ligjin nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile"; Ligjit nr.152/2015 "Shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin",VKM nr.1080 datë 22.12.2010 "Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe në kullota, si dhe për krijimin e njësisve vullnetare të shuarjes së zjarreve", pas propozimit nga Agjencia e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave dhe Kryetari i Bashkisë Kurbin,Këshilli Bashkiak;

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit "Për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kullosor në Bashkinë Kurbin për vitin 2023",sipas materialit bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari Bashkisë.

>Prefektit Të Qarkut Lezhë

>Agjencia e Administrimit Të Pyjeve dhe Kullotave

>Arkivi

SEKERETARI I KESHILLIT

Arber LEKA

KRYETARE E KESHILLIT

Edlira LLESHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN
AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. 1452 Prot.

Laç, më 09.03.2023

MIRATOHET
KRYETAR
MAJLINDA CARA



PLAN MASASH
"PËR PARANDALIMIN DHE SHUARJEN E
ZJARREVE NË FONDIN PYJOR/KULLOSOR NË BASHKINË KURBIN
PËR VITIN 2023"

Në zbatim të nenit 27 pika 5, nenin 54 shkronja "k" të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; neni 30 pika 4, gërma 'b/' 'c' të Ligjit nr.57/2020 "Për pyjet"; Ligjin nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile"; Ligjit nr.152/2015 "Shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", VKM nr.1080 datë 22.12.2010 "Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe në kullota, si dhe për krijimin e njëjësive vullnetare të shuarjes së zjarreve", Agjencia e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave (në vijimësi APK) dhe Kryetari i Bashkisë Kurbin, për të rritur efikasitetin e strukturave vendore, për parandalimin, përbalimin dhe minimizimin e dëmeve në sipërfaqet pyjore nga rreziku i zjarrit, si dhe për të zbuluar në kohë situatat që mund të ndodhin në pyje dhe kullota, hartohet ky plan-masash nga APK, i cili synon të arrijë:

NR.	PROBLEMET QË DO TË TRAJTOHEN	STRUKTURA E NGARKUAR	VENDI	AFATI
1	Të bëhet një takim me personelin e bashkisë dhe të Nj.A - për t'u njohur me detyrat për mbrojtjen e pasurisë pyjore.	EMC, AAPK	Bashki	Brenda Muajt Prill
2	Të bëhet inventarizimi i të gjitha mjeteve që shërbejnë për fikjen e zjarreve dhe ato që kanë nevojë për kolaudim të vihen në efijencë të plotë.	Financa dhe APK	Qendra dhe Nj.A	Brenda Muajt Prill

3	Për çdo rast zjarri të konstatuar, të plotësohet dokumentacioni përkatës dhe të bëhet kallzimi penal pranë Prokurorisë, në referencë të neneve nr.151, 206/a dhe 206/b të Kodit Penal.	APK	Sipas rastit konkret	Sipas rastit
4	Nën kujdesin e APK, Nj.A (Kryetarët e fshatrave), të hartojnë listat e grupeve vullnetare të shuarjes së zjarrit, në bazë fshati, lagje, me njerëz të përshtatshëm, në krye të të cilave të jenë vetë kryetarët dhe personeli pyjor.	Nj.A, Kryetarët e fshatrave	Çdo fshat	10 Maj
5	Vrojtim-sinjalizimi të jetë prioritet i punës së personelit të Nj.A, Kryetarët e fshatrave, për të dhënë informacion të saktë dhe të shpejtë.	Nj.A, Kryetarët e fshatrave	Çdo fshat	10 Maj
6	Secili kryetar fshati, të studiojë zonat e nxehta të territorit të vet. Nj.A të marrin kontakte të vazhdueshme me Kryetarët e fshatrave, barinjtë etj. Të shkëmbehen nr.e celulareve etj.	Nj.A, Kryetarët e fshatrave	Çdo fshat	15 Maj
7	Në rast zjarri, mjetet logjistike (vegla pune, kmesa, kazma, pompa, lopata) të vihen në dispozicion të punonjesve që do të nisen për ndalimin, izolimin fikjen e zjarrit, duke marrë secili nga një vegël pune.	Nj.A, Kryetarët e fshatrave	Sipas rastit	Sipas rastit
8	Organizimin e sistemit të vrotimit dhe informimit për konstatimin dhe informimin në kohë të shfaqjes së zjarrit.	Nj.A, Kryetarët e fshatrave	Në bazë fshatrash	10 Maj
9	Organizimin e takimeve, bisedave apo publikime sensibilizuese me kryetarët e fshatrave, me banorët dhe përdoruesit e sipërfaqeve pyjore, kullotave, etj., për rreziqet dhe dëmet që vijnë nga zjarret, veçanërisht nga ato në pyje, për njohjen më ligjshmërinë, detyrimet dhe përgjegjësitë, si dhe për organizimin e punonjesve të këtyre subjekteve për ndërhyrje në raste zjarri.	MNZ në bashkëpunim me APK	Në secilën Nj.A	15 Maj
10	Trajnimin e personave dhe strukturave përgjegjëse të bashkisë, në njësitë administrative, të shërbimit pyjor, të policisë bashkiake, të forcave vullnetare, etj, për përmirësimin e sistemit të vrotimit, sinjalizimit dhe të veprimit në rastet e zjarrit.	MNZ në bashkëpunim me APK	Bashki	5 Maj
11	Përcaktimin e vëndfurnizimeve me ujë të mjeteve ajrore të fikjes së zjarreve.	MNZ, EMC, Ujësjellësi	Çdo fshat	Sipas rastit